



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9.4.2024

Nr: 39

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES KRISTIAN LUIGJ SHKRELI, KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË VAU-DEJËS, QARKU SHKODËR, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"

Sot në datën 9.4.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli, Kryetar në Bashkinë Vau-Dejës, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Palë të interesuara: Z. Kristian Luigj Shkreli, kryetar në Bashkinë Vau-Dejës, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar; ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

(1)

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për

Data: 9.4.2024 Nr: 39
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Kristian Luigj Shkreli, Kryetar në Bashkinë Vau-Dejës, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"

administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kryetari i bashkisë.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Kristian Luigj Shkreli, Kryetar në Bashkinë Vau-Dejës, në datën 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me nr. SHK-PS 10052 unik. KQZ bëri verifikimin “*prima facie*” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmoi hapat e mëposhtëm:

1. Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike i kërkoi informacion zyrës së gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se subjekti vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
2. Nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, i kërkoi informacion zyrës së gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se subjekti vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli, në vitin 2007 rezulton se ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit nga “Shkreli” në “Kola” dhe më pas në vitin 2010 ka ndryshuar nga “Kola” në “Shkreli”.

(2)

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z.t Kristian Luigj Shkreli, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshuar rubrikën e mbiemrit nga “Shkreli” në “Kola” dhe nga Kola në “Shkreli”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 7 “*A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar se në Torino, Itali, në vitin 2007, është ndaluar për mungesë dokumentacioni, për të cilën nuk disponon ndonjë akt që ka lidhje me deklarin e faktit.
- Pyetjes 8 “*A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar se ka jetuar në Torino, Itali, për arsye emigracioni në periudhën 2005 – 2007.

Nga konstatimet e mësipërme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4095 prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarinave të bëra.

Me shkresën nr. 606/35 ext 23 prot., datë 01.02.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Kristian Luigj Shkreli, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular;
- Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale”;

- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Rezulton të jetë urdhëruar EKSPULS nga territori i shtetit italian, me vendimin nr.81/2007 të Prefektit të Provincës së Cuneos, për arsye se rezultoi i papajisur me dokumente të rregullta qëndrimi në bazë të rregullave mbi qëndrimin e shtetasve të huaj.
- Për shtetasin shqiptar Kristian Shkreli është urdhëruar: EKSPULS (LARGIMI) NGA TERRITORI ITALIAN, konform nenit 13, paragrafi 2, germa b të Dekretit Legjislativ 286/98 ndryshuar me ligjet 189/02 dhe 271/04, që parashikon ekspulsin kur një shtetas i huaj nuk ka bërë kërkesë për pajisje me leje qëndrimi brenda afatit të parashikuar.

(3)

Në përfundim të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 587, datë 24.05.2023, i ka dhënë mandatin z.Kristian Luigj Shkreli, si Kryetar i Bashkisë Vau-Dejës.

(4)

Në seancën publike të KQZ-së të datës 20.02.2024, për vlerësimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli, përfaqësuesi me autorizim (nr.13 prot, datë 19.02.2024) i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Marash Logu, ka kërkuar shtyrjen e seancës publike për marrjen e informacionit nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nëse kundër këtij subjekti është regjistruar ndonjë procedim penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 529 prot., datë 23.2.2023, ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nëse ka procedim penal të regjistruar në ngarkim të subjektit vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. 3408/1 prot., datë 12.3.2023, i ka kthyer përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me subjektin Kristian Luigj Shkreli. Për këtë subjekt nuk rezulton të jetë regjistruar një procedim penal.

Në seancën publike të datës 9.4.2024, për vlerësimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli, përfaqësuesi i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Marash Logu ka cituar se është njohur me përgjigjen e SPAK-ut, vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe FVD-në e dorëzuar nga subjekti vetëdeklarues.

Gjithashtu, ka deklaruar se nuk duhet të merret e mirëqenë shkresa e SPAK-ut dhe as vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme, pasi puna e bërë nga kjo e fundit është sipërfaqësore dhe shkëmbimi i informacionit mes këtyre organeve është i paqartë.

“Ne kemi indicie se subjekti vetëdeklarues Shkreli ka më shumë se një vendim dëbimi nga një shtet i huaj dhe këto masa dëbimi nuk janë për mungesë dokumentacioni. Do të ishte e rëndësishme gjithashtu që Prokuroria e Përgjithshme të hetonte më tej se cilat janë arsyet që subjekti ka ndryshuar të dhënat e gjeneraliteteve, për më tepër kur ky ndryshim lidhet pikërisht më periudhën e dëbimit nga shteti italian....

Nisur nga sa më sipër, do të vlerësonim që KQZ-së t’i vihej në dispozicion e gjithë korrespondenca shkresore midis Policisë Kriminale dhe Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe korrespondenca e Prokurorisë së Përgjithshme me Ministrinë e Drejtësisë nëse informacioni ka qenë gjithëpërfshirës apo ka qenë një verifikim specifik vetëm për atë çfarë ka deklaruar subjekti në FVD.

Ne kemi indicie se z. Kristian Shkreli ka një procedim penal dhe është e nevojshme që KQZ-ja të kryejë një procedurë verifikimi më të thelluar në lidhje me të dhënat që prokuroria ka shqyrtuar në lidhje me deklaratimet e vetë subjektit vetëdeklarues. Ajo që ne kërkojmë është që kërkesat tona të shqyrtohen dhe të vlerësoheshin si të drejta.”

(5)

KQZ-ja vlerëson se për subjektin vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli nuk ekziston ndonjë shkak, i cili sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2025 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” bën t’i ndërpritet mandati i kryetarit të bashkisë.

Ky ligj ka përcaktuar shkaqet/rastet kur një person ndalohet të kandidojë apo edhe të ushtrojë detyrën e kryetarit të bashkisë. Sipas këtij ligji shkaqet lidhen krahas të tjerave me lloj veprash penale të kryera, ose masa dënimi penal të marra në kohë të ndryshme nga subjekti vetëdeklarues.

Për z. Shkreli nuk rezulton të ketë ndonjë vendim penal në Republikën e Shqipërisë. Për të rezulton që të jetë urdhëruar ekspuls nga territori i shtetit italian (largim nga territori italian) parashikuar nga neni 13, paragrafi 2, gërma “b” të Dekretit Legjislativ 286/98, ndryshuar me ligjet 189/02 dhe 271/04, që parashikon ekspulsin kur një shtetas i huaj nuk ka bërë kërkesë për pajisje me leje qëndrimi brenda afatit të parashikuar.

Neni 2 i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” ka përcaktuar në tërësinë e vet rastet e ndalimit të ushtrimit të një funksioni publik, të cilat lidhen me disa vepra penale pavarësisht masës së dënimit, ose me masë dënimi penal me heqje lirie, pavarësisht llojit të veprës penale. Në rastin konkret nuk përmbushet asnjë nga kriteret e përcaktuara sa më sipër, pasi z. Kristian Shkreli nuk është gjendur fajtor për kryerjen e ndonjë krimi dhe as është dënuar me burgim për kryerjen e një krimi.

Neni 2 i ligjit nr. 138/2015 nuk e parashikon veprën penale “*Ekspuls ose largim nga territori i një shteti*”, që të përfshihet në fushën e ndalimit për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik.

Në lidhje me pretendimin që z. Kristian Luigj Shkreli është dëbuar nga territori i shtetit italian dhe që është dëbuar për arsye të kryerjes së ndonjë vepre penale, rezultatet e verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme nuk e përmbajnë një fakt të tillë.

(6)

KQZ-ja vlerëson se nuk qëndron pretendimi në lidhje me administrimin e gjithë korrespondencës shkresore midis Policisë Kriminale, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme për të vërtetuar nëse informacioni i marrë ka qenë gjithëpërfshirës apo ka qenë një verifikim specifik vetëm për atë çfarë ka deklaruar subjekti në FVD. Neni 8, pika 1, e ligjit nr. 138/2015 dhe kreu

V, pika 3, shkronja “b”/ii), të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit ka përcaktuar se është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Në rastin konkret, KQZ-ja ka përmbushur detyrimin e saj duke përcjellë rastin për verifikim të mëtejshëm në organin kompetent.

KQZ-ja nuk vlerëson se si e ka përmbushur detyrën Prokuroria e Përgjithshme në kryerjen e verifikimit/hetimit për subjektin vetëdeklarues, por merr të mirëqenë se si Prokuroria ka arritur në këtë konkluzion.

Neni 2, pika 2, i ligjit nr. 138/2015 përcakton qartë se: “...për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.”

Gjithashtu, KQZ-ja vlerëson se nuk qëndron edhe pretendimi se komunikimi shkresor nëpërmjet SPAK-ut dhe Prokurorisë së Përgjithshme është i paqartë.

Kërkesa që KQZ-ja i ka adresuar SPAK-ut nëse është regjistruar ndonjë procedim penal për llogari dhe në emër të z. Shkreli, ka qenë e qartë, dhe përgjigja e SPAK-ut ka qenë ezauruese. Në emër të z. Shkreli nuk ka asnjë kallëzim penal të regjistruar.

Në kuptim të gjithë sa më sipër, konkludojmë se asnjë nga kërkesat e paraqitura gjatë shqyrtimit administrativ nga përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë” nuk duhet të pranohen. Nuk ka asnjë rrethanë të re, e cila të vendosë palën e interesuar në pozitën për të bërë kërkime të reja, pasi në thelb këto kërkime lidhen me verifikimet që Prokuroria e Përgjithshme ka kryer tashmë në kuadër të verifikimit të thelluar.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorit të Përgjithshëm, korrespondencës shkresore me SPAK, konstatoj se:

Subjekti vetëdeklarues Kristian Luigj Shkreli, Kryetar i Bashkisë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Kristian Luigj Shkreli, Kryetar i Bashkisë Vau-Dejës, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të kryetarit.
2. Vazhdimin e mandatit të z. Kristian Luigj Shkreli, Kryetar i Bashkisë Vau-Dejës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI